


Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar sipas Marrëveshjes së Parisit

Manual për monitorimin e KKP-së 2021-2030



Ky dokument është hartuar nëpërmjet Projektit për Mbështetje Parapërgatitore të Fondit për Klimën e Gjelbër për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë "Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar" 2020-2022. Projekti është zbatuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane.

Instituti i Kërkimeve Urbane është Partner i Fondit për Klimën e Gjelbër në Zbatimin e Projekteve Parapërgatitore për Shqipërinë, nëpërmjet të cilave ai mbështet Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në zhvillimin e kuadrit strategjik kombëtar për ndryshimin e klimës si dhe të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për zbatimin e tij.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Institutit të Kërkimeve Urbane. Instituti i Kërkimeve Urbane nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit të përmbajtjes së dokumentit.

Hartuar nga:

Michel Köhler, the greenwerk.

With the contribution of:

Edlir Vokopola, Instituti i Kërkimeve Urbane

Entela Kallamata, Instituti i Kërkimeve Urbane

Prill, 2022

© 2023 Instituti i Kërkimeve Urbane
Rruga "Asim Vokshi", Ndërtesa 14, Hyrja 11, Ap. 56
1057 Tiranë, Shqipëri
www.uri.org.al

Disa të drejta të rezervuara.

Ky punim është objekt i së drejtës së autorit. Meqenëse Instituti i Kërkimeve Urbane përkrah shpërndarjen e njohurive të tij, përmbajtja e punimit mund të riprodhohet, plotësisht ose pjesërisht, për qëllime jo tregtare, dhe duke dhënë referencë të plotë të autorit.

Punimi grafik: Jolin Matraku

Printuar: Express Print and Communication, Tiranë, Mars 2023



PARAFJALË

Ky dokument është një manual për zhvillimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar të Shqipërisë 2021-2030; ai i shërben Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e politikave dhe masave të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021-2030, si dhe për përmbushjen me cilësi të detyrimeve të Shqipërisë kundrejt Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës dhe Marrëveshjes së Parisit.

Instituti i Kërkimeve Urbane i është mirënjohës Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për koordinimin e komunikimit zyrtar ndërmjet institucioneve gjatë zbatimit të Projektit për Mbështetje Parapërgatitore "Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar" 2020-2022.

Përmbajtja

- 1 HYRJE
- 1 METODOLOGJIA

- 1 **MATJA, RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI I NDRYSHIMIT TË KLIMËS**
 - 1 Përkufizime
 - 3 Kërkesat ndërkombëtare

- 9 **PRAKTIKA TË MIRA RAJONALE – GJEORGJIA**
 - 9 Kuadri ligjor
 - 10 Kuadri institucional
 - 10 Operacioni teknik
 - 10 Përfshirja e sektorit privat
 - 10 Zhvillimi i kapaciteteve
 - 10 Mësimet e marra

- 10 **STATUS QUO E MRV SË TË DHËNAVE TË NDRYSHIMIT TË KLIMËS NË SHQIPËRI**

- 13 **HAPAT PËRPARA PËR ZHVILLIMIN E MRV SË TË DHËNAVE TË NDRYSHIMIT TË KLIMËS NË SHQIPËRI**
 - 13 Sfidat në ngritjen dhe zbatimin e sistemit MRV
 - 13 Elementet për një sistem MRV eficient dhe efektiv

- 19 **PËRFUNDIME**

Figurat

- 8 Figura 1: Llojet e sistemeve të matjes, raportimit dhe verifikimit të zbutjes
- 9 Figura 2: Llojet e sistemeve të matjes, raportimit dhe verifikimit të zbutjes
- 10 Figura 3: Përfitimet kryesore dhe specifike të raportimit të klimës
- 11 Figura 4: Ndërlidhja e kërkesave për raportim të KKKBND dhe BE për Shqipërinë
- 11 Figura 5: Kuptimi i udhëzimit për transparencë
- 12 Figura 6: Plani kohor i tranzicionit drejt KTP
- 13 Figura 7: Kuptimi i vendimeve të KTP
- 15 Figura 8: Tabelat e përditësuara të raportimit për energjinë e GES
- 16 Figura 9: Kuadri i sistemit MRV të Gjeorgjisë
- 21 Figura 10: Të dhënat për energjinë në KKP
- 22 Figura 11: Rregullim i mundshëm institucional për një sistem MRV për të dhënat e energjisë
- 23 Figura 12: Kapacitetet e nevojshme për zbatimin e një sistemi MRV
- 24 Figura 13: Organet dhe nismat që mbështesin ngritjen e kapaciteteve për sistemet MRV

Shkurtime

AEE	Agjencia e Eficiencës së Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
CMA	Konferenca e Palëve që shërben si takim i Palëve në Marrëveshjen e Parisit
FPT	Formate të Përbashkëta Tabelare
GCF	Green Climate Fund [Fondi për Klimën e Gjelbër]
GES	Gaz me efekt serë
GKE	Grupi Konsultativ i Ekspertëve
GNPNK	Grupi Ndërmnistror i Punës për Ndryshimet Klimatike
INSTAT	Instituti i Statistikës
IPA	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit
KeP	Konferenca e Palëve
KK	Komunikim Kombëtar
KKKBND	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës
KKP	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
KNNADM	Konventa mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Madhe
KTP	Kuadri i Transparencës së Përmirësuar
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MP	Marrëveshja e Parisit
MPU	Modalitetet, Procedurat dhe Udhëzimet
MRV	Matja, Raportimi, Verifikimi
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHP	Mekanizmi për Zhvillim të Pastër
NNK	Nisma Ndërkombëtare për Klimën
OZHQ	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës
RDP	Raporti Dyvjeçar Përditësues
RDT	Raporti Dyvjeçar i Transparencës
RMM	Rregullorja e Mekanizmit Monitorues
SNKPV	Strategjia për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimet 2019-2030
TPR	Tabela të Përbashkëta të Raportimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKPZ	Veprim i Përshtatshëm Kombëtar për Zbutje

1. HYRJE

Ky dokument shërben si manual për zhvillimin e një sistemi kombëtar matjeje, raportimi dhe verifikimi të të dhënave të ndryshimit të klimës dhe Kontributit të Përcaktuar Kombëtar të Shqipërisë 2021-2030. Në të analizohen elementet kryesore institucionale, ligjore dhe procedurale dhe jepen rekomandime për përmbushjen e kërkesave të Shqipërisë kundrejt Konventës Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës dhe Bashkimit Evropian.

2. METODOLOGJIA

Manuali është përgatitur mbi bazën e pesë proceseve të mëposhtme metodologjike:

1. Punë kërkimore mbi kërkesat e BE-së dhe KKKBND-së për matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave të ndryshimit të klimës;
2. Rishikimi i bazës ligjore ekzistuese kombëtare për matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave të ndryshimit të klimës;
3. Mësimet e nxjerra nga procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave gjatë përmirësimit të Kontributit të Përcaktuar Kombëtar të Shqipërisë 2021-2030 nëpërmjet masave shtesë të eficiencës së energjisë¹;
4. Rishikimi i praktikave të mirë rajonale mbi ngritjen e një sistemi kombëtar të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave të ndryshimit të klimës;
5. Konsultimi me grupet e interesit të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave kombëtare të ndryshimit të klimës.

3. MATJA, RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI I NDRYSHIMIT TË KLIMËS

Kapitulli në vijim paraqet karakteristikat, rëndësinë dhe përfitimet e matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave të ndryshimit të klimës. Ai përshkruan më tej kërkesat ndërkombëtare ekzistuese, si dhe kërkesat e ardhshme që Shqipëria do të duhet të përmbushë si Palë në UNFCCC dhe vend kandidat në BE.

3.1. Përkufizime

Matja (**M**) zbatohet për mbledhjen e të dhënave për emetimin e gazeve me efekt serrë, veprimet për zbutjen dhe efektin e tyre, dhe për nevojat për mbështetje;

Raportimi (**R**) përfshin përpilimin transparent të këtij informacioni në inventarë dhe formate të tjera të standardizuara për ta bërë atë të aksesueshëm për një sërë përdoruesish dhe për të lehtësuar dhënien e informacionit për publikun.

Verifikimi (**V**) përfshin vlerësimin dhe përcaktimin periodik të plotësisë, konsistencës dhe besueshmërisë së informacionit të raportuar përmes një procesi të pavarur, i cili mund të vendoset në nivel ndërkombëtar ose kombëtar².

Siç ilustron në figurën 1, për të gjeneruar informacionin dhe të dhënat e nevojshme për qëllime të ndryshme raportimi, të tilla si Komunikimet Kombëtare të KKKBND-së, Raportet Dyvjeçare Përditësuese dhe, nga viti 2023, Raportet Dyvjeçare të Transparencës, si edhe kërkesat e BE-së për raportim, sistemet kombëtare duhet të mbulojnë:

- **MRV e emetimeve në nivele të ndryshme** (projekt, korporatë, qytet/provincë, sektorial ose kombëtar) për të përcaktuar inventarët e GES-eve që do të përfshihen në Komunikimet Kombëtare, Raportet Dyvjeçare Përditësuese dhe Raportet Dyvjeçare të Transparencës.
- **MRV e veprimeve zbutëse**, për të përcaktuar një skenar bazë dhe monitorimin e emetimeve të aktiviteteve të ndryshme. Kjo shkon përtej vetëm monitorimit të GES-eve.
- **MRV e mbështetjes**, financat, transferimi i teknologjisë dhe ngritja e kapaciteteve të marra (jo e detyrueshme për vendet në zhvillim, por për të gjitha vendet anëtare të BE-së).


Një sistem i fuqishëm kombëtar MRV krijon përmirësimin e transparencës, e cila është një nga elementet qendrore të Marrëveshjes së Parisit. KKP-të janë të vendosura në nivel kombëtar dhe nuk ka ndëshkime për mos përmbushjen e premtimeve të përfshira në to. Aktualisht, në regjimin shumëpalësh të klimës pas Protokollit të Kiotos, zbatohet vetëm politika "emërtim dhe turpërim".

Neni 13 i Marrëveshjes së Parisit përcakton "Kuadrin e Transparencës së Përmirësuar", "për të ndërtuar besim dhe siguri të ndërsjellë dhe për të promovuar zbatimin efektiv" nëpërmjet ofrimit të informacionit për "veprim dhe mbështetje". Në thelb, KTP-ja do të tregojë nëse (dhe si) po funksionon Marrëveshja e Parisit. Kështu, një MRV konstante e emetimeve, veprimet zbutëse dhe, nëse është e aplikueshme, mbështetja

¹ Instituti i Kërkimeve Urbane, 2021a

² WRI, 2016

Figura 1: Llojet e matjes, raportimit dhe verifikimit të zbutjes



Burimi: WRI (2016)

ndërkombëtare, janë parakushte për përmirësimin e KKP-së dhe kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të Marrëveshjes së Parisit (shih Figurën 2 për një ilustrim skematik të procesit deri në vitin 2030). Ndërsa KKKBNB përcakton afatet kohore kur vendet duhet të raportojnë KKP-të e tyre, procesi themelor i MRV-së duhet të përcaktohet në nivel kombëtar, duke marrë parasysh rrethanat kombëtare.

Përveç përputhshmërisë me kërkesat e raportimit në nivel ndërkombëtar, MRV-ja e progresit të KKP-së vjen me disa përfitime shtesë për vendet (krahaso edhe Figurën 3). Më të rëndësishmet janë:

- Ndërtimi i një inventari gjithëpërfshirës të emetimeve;

- Mbështetja për një vlerësim të përshtatshëm zbutës, pasi një MRV gjithëpërfshirëse:
 - informon politikat, planet, strategjitë dhe programet;
 - identifikon mundësitë për reduktimin e emetimeve në të gjithë sektorët;
 - lejon komunikimin e përpjekjeve, sfidave dhe nevojave;
 - përmirëson aksesin në mbështetje;
- Së fundi, zbatimi i një procesi MRV bën të mundur:
 - rritjen e ndërgjegjësisë të palëve të interesuara;
 - rritjen e pranimit politik;
 - rritjen e kapaciteteve të ekspertëve të sektorit.

Figura 2: Qëllimet e Marrëveshjes së Parisit dhe rishikimet e KKP





Figura 3: Përfitimet kryesore dhe specifike të raportimit të klimës



Burimi: GIZ, 2018

3.2.Kërkesat ndërkombëtare

Si Palë në KKKBND dhe si vend kandidat për në BE, Shqipëria është e angazhuar të përmbushë disa kërkesa raportimi. Siç ilustron në Figurën 4, kërkesat për raportim janë të ndërlidhura dhe një sistem i ardhshëm MRV duhet të përpiqet të realizojë sinergji. Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë në mënyrë më të detajuar raportimet dhe detyrimet përkatëse.

3.2.1. Kërkesat nga KKKBND

Shqipëria nuk është anëtare e Aneksit 1 të Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimin e Klimës të vitit 1992, marrëveshja e parë shumëpalëshe që rregullon veprimin klimatik. Vendet që nuk janë pjesë e Aneksit 1 janë ato të cilat historikisht kanë emetime të ulëta dhe ekonomi më pak të përparuara. Megjithëse struktura e ekonomisë së Shqipërisë është e ngjashme me atë të vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik, Shqipëria nuk u klasifikua si "ekonomi në tranzicion".

Negociatat e mëtejshme rezultuan në miratimin e Protokollit të Kiotos në vitin 1997, i cili u fokusua në detyrimet për zbutjen e klimës për vendet e Aneksit 1. Protokollin hyri në fuqi vetëm në vitin 2005. Pjesërisht për shkak të kundërshtimit të SHBA-së, efektiviteti i

tij ishte i kufizuar. Negociatat rifilluan, por dështimi i bisedimeve në Kopenhagen në vitin 2009 kërkoi një riorientim themelor të angazhimeve shumëpalëshe. Instrumenti më i fundit shumëpalësh që rregullon veprimet klimatike është Marrëveshja e Parisit e vitit 2015. Kjo marrëveshje vendos përgjegjësi të konsiderueshme mbi vendet për të formuluar KKP-të.

Shqipëria e ratifikoi Marrëveshjen e Parisit më 21 shtator 2016, duke u angazhuar për qëllimin ambicioz "për të mbajtur një rritje të temperaturës globale këtë shekull nën 2 gradë Celsius mbi nivelet para-industriale dhe për të vazhduar përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës edhe më tej në 1.5 gradë Celsius", si edhe një sërë detyrimesh ligjrisht të detyrueshme, duke përfshirë përgatitjen 5-vjeçare të KKP-ve dhe raportimin rigoroz nën Kuadrin e Transparencës së Përmirësuar. Në Konferencën e Klimës për Marrëveshjen e Parisit KeP24/CMA1 në Katowice, 2018 dhe KeP26/CMA3 në Glasgow, 2021, u dakordësua mbi rregullat e hollësishme të zbatimit të KKP-së nga çdo vend.

Përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Parisit, palët që nuk ishin pjesë e Aneksit 1 tashmë ishin subjekt i një sërë detyrimesh transparence, megjithëse këto vareshin nga kapacitetet e tyre, duke reflektuar

Figura 4: Ndërlidhja e kërkesave për raportim të KKKBND dhe BE për Shqipërinë




Figura 5: Kuptimi i udhëzimit për transparencë

	Raportimi	Rishikimi	Vërejtje mbi raportimet
Marrëveshja e Parisit (Të gjitha vendet)	Raporti Dyvjeçar i Transparencës Raporti i Inventarit Kombëtar	Rishikimi i ekspertëve teknikë	Vërejtje e shumanshme e ecurisë
Konventa	Raporti Dyvjeçar Përditësues (Vende në zhvillim)	Analizë teknike (Vende në zhvillim)	Shkëmbime këndvështrimesh (Vende në zhvillim)
Konventa	Komunikimi kombëtar (Të gjitha vendet)	Rishikimi teknik (Vendet e zhvilluara)	
Kërkesa që do të mbivendosen nga kërkesat e Marrëveshjes së Parisit		Kërkesa që do të mbeten në fuqi, dhe që mund të ndërthuren me kërkesat e Marrëveshjes së Parisit	

Burimi: Öko-Institut.e.V, 2021


rrethanat kombëtare. Shqipëria paraqiti, për shembull, Komunikimin e saj të Tretë Kombëtar në Tetor 2016. Figura 5 përshkruan kërkesat përkatëse të raportimit sipas Marrëveshjes së Parisit dhe Konventës Kuadër, rishikimet teknike shoqëruese dhe marrjen në konsideratë të raporteve në nivel ndërkombëtar nga KeP-ja ose CMA-ja.

Në Tetor 2021, Shqipëria paraqiti një grup të konsiderueshëm parashtresash në KKKBND: Raportin e Parë Dyvjeçar Përditësues, Raportin Kombëtar të Inventarizimit të GES-eve dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes, duke përbushur kështu shumë nga kërkesat e mëparshme ekzistuese të transparencës. Një Komunikim i Katërt Kombëtar pritet të përfundojë në vitin 2022.

Palët e interesuara kombëtare dhe ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar në këtë projekt pajtohen se sistemi ekzistues MRV ka nevojë për fuqizim të konsiderueshëm, në mënyrë që Shqipëria të përbushë kërkesat e KTP-së. Në vend të mbledhjes ad hoc të të dhënave, sistemi KTP kërkon mbledhje më të rregullt / të vazhdueshme të të dhënave me cilësi të lartë, transparente dhe të verifikueshme. Figura 6 sqaron evolucionin e shkallëzuar nga sistemi aktual MRV në KTP-së.

Neni 13 i Marrëveshjes së Parisit përcakton dy drejtime të transparencës, përkatësisht një për veprimin për ndryshimet klimatike dhe një për mbështetjen për palët e vendeve në zhvillim.

Figura 6: Plani kohor i tranzicionit drejt KTP



Burimi: UNFCCC, 2020

Sipas kuadrit për transparencën e veprimit, Palëve në MP u kërkohet ligjërisht të sigurojnë komunikime që do t'i nënshtrohen një shqyrtimi ekspert teknik, modalitetet e të cilave do të përcaktohen nga CMA në mbledhjen e saj të parë. Komunikimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1. një raport kombëtar të inventarit të emetimeve të GES-eve sipas burimeve dhe largimeve nga depot, duke përdorur metodologji të praktikave të mira të pranuar nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës, dhe
2. informacionin e nevojshëm për të gjurmuar progresin e bërë në zbatimin dhe arritjen e KKP-ve (MP, Neni 13(7)).

Gjithashtu, duhet të paraqitet për shqyrtim një komunikim mbi përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës, i cili mund të përfshijë një plan kombëtar përshtatjeje që komenton prioritetet kombëtare dhe nevojat për mbështetje (MP, Neni 7(10)).


Duke marrë parasysh parimin e përgjegjësive të përbashkëta, por të diferencuara dhe aftësive përkatëse dhe në dritën e rrethanave të ndryshme kombëtare, shqyrtimi i ekspertit teknik do të sigurojë një kuptim të qartë të informacionit të paraqitur dhe do të identifikojë praktikën e mira, prioritetet, nevojat dhe mangësitë (MP, Neni 13 (5)).

Sipas kuadrit për transparencën e mbështetjes, Palët e vendeve të zhvilluara dhe Palët e tjera që ofrojnë mbështetje duhet të ofrojnë informacion në lidhje me mbështetjen financiare, transferimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve të ofruara për palët e vendeve në zhvillim (MP, Neni 13(6)).

Një shqyrtim shumëpalësh lehtësues i progresit do të vlerësojë informacionin e dhënë, së bashku me informacionin mbi mbështetjen e ofruar Palëve të vendeve në zhvillim për planifikimin dhe zbatimin e masave të përshtatjes (MP, Neni 7(7)) si edhe mbi mbështetjen financiare, transferimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve ofruar për Palët e vendeve në zhvillim sipas neneve 9, 10 dhe 11 (MP, Neni 13(11)). COP24 i Katowice vendosi që deri në fund të vitit 2024 vendet duhet të dorëzojnë "Raportin e tyre të Parë Dyvjeçar të Transparencës" dhe "Raportin Kombëtar të Inventarit". Ky udhëzues raportimi njihet si Modalitetet, Procedurat dhe Udhëzimet (MPG) të përfshira në Aneksin e Vendimit 18/CMA.1.

KeP26 ra dakord se si do të raportohej informacioni (tabelat me rreshta, kolona, formate të përbashkëta të përcaktuara etj.). Ky sistem raportimi është i zakonshëm, por lejon fleksibilitet për vendet në zhvillim për sa i përket rreshtave, kolonave dhe tabelave "kolaps" dhe "zgjerues". I gjithë raportimi

Figura 7: Kuptimi i vendimeve të KTP



Burimi: Öko-Institut e.V, 2021

do t'i nënshtrohet "shqyrtimit të ekspertit teknik" dhe një procesi të rishikimit të njohur si "konsiderata shumëpalëshe lehtësuese të progresit".

Figura 7, pasqyron një përmbledhje të udhëzimeve teknike të vendimeve të Katowice dhe Glasgow.

3.2.2. Kërkesat nga BE

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e cila është korniza për marrëdhëniet midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, ka hyrë në fuqi në Shqipëri që nga 1 Prilli 2009³. Pasi Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE më 28 Prill 2009, asaj iu dha statusi i kandidatit në 2014. Më 25 Mars 2020, Këshilli vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë. Këshilli i ngarkoi Komisionit të raportonte për një sërë çështjesh që duheshin adresuar nga Shqipëria përpara Konferencës së Parë Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit. Në Maj të vitit 2021, Komisioni Evropian përcaktoi se janë përmbushur kushtet që duhet të plotësohen para mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare të negociatave të anëtarësimit. Hapi tjetër në proces do të jetë një vendim mbi kornizën e negociatave dhe caktimi i një date për konferencën e parë.

Një parim themelor i negociatave për anëtarësimin në BE është se vendet duhet të transpozojnë dhe zbatojnë plotësisht legjislacionin e BE-së deri në momentin e anëtarësimit. Në këtë sfond, Shqipëria ka ndërmarrë tashmë disa hapa në asimilimin e politikave dhe strategjive të saj kombëtare me standardet e BE-së. Procesi i anëtarësimit është i strukturuar sipas kapitujve të acquis (aktualisht 35) dhe do të ndihmojë për të identifikuar se në cilat fusha nevojiten reforma. Progresi në secilën fushë monitorohet në raportet vjetore të vendit. Në lidhje me një MRV të veprimit klimatik, veçanërisht në lidhje me reduktimin e emetimeve të GES-eve, kanë qenë të rëndësishme për Shqipërinë kornizat e mëposhtme të BE-së:

- Mekanizmi i Monitorimit të Klimës: Rregullorja e Mekanizmit të Monitorimit të Klimës (525/2013) është korniza përkatëse deri më 1 Janar 2021, por dispozitat kryesore të raportimit të saj ende zbatohen për raportimin për vitet 2019 dhe 2020, i cili zhvillohet përkatësisht në 2021 dhe 2022⁴.
- Bashkimi i Energjisë dhe Veprimit për Klimën: Nga viti raportues 2021 e në vazhdim, zbatohet Rregullorja për Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimit për Klimën (2018/1999).

3 EU, 2021a

4 EU, 2021b

Reforma rregullatore do të ndihmojë BE-në të arrijë objektivat e saj për klimën dhe energjinë për vitin 2030. Për më tepër, sistemi i qeverisjes i përcaktuar nga rregullorja e qeverisjes së Unionit të Energjisë është unik në mënyrën se si integron planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë, si edhe planifikimin e energjisë dhe klimës⁵. Për sa i përket pajtueshmërisë së saj me të dy rregulloret, Shqipëria nuk është ende plotësisht në përputhje me Mekanizmin e Monitorimit të Klimës dhe në të njëjtën kohë po hedh tashmë elementë përkatës për një pajtueshmëri me Rregulloren për Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimet për Klimën⁶.

Nën Mekanizmin e Monitorimit të Klimës, Komisionit i kërkohet të përgatisë një raport vjetor mbi progresin drejt objektivave të Kiotos dhe BE-së. Prandaj, vendeve u kërkohet të paraqesin informacionin përkatës për këtë raport, bazuar në proceset dhe strukturat e krijuara kombëtare. Informacioni që duhet të raportohet, bazuar në një sistem të standardizuar të raportimit elektronik (d.m.th. tabelat RMM) përfshin, ndër të tjera, emetimet e shtatë gazeve serrë (inventari i gazeve serrë) nga të gjithë sektorët; parashikimet, politikat dhe masat për të ulur emetimet e gazeve serrë; masat kombëtare për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike; strategjitë e zhvillimit me karbon të ulët; mbështetje financiare dhe teknike për vendet në zhvillim dhe angazhime të ngjashme; dhe "përdorimin e të ardhurave nga qeveritë kombëtare nga ankandi i lejimeve në sistemin e tregtimit të emetimeve të BE-së" (ato janë zotuar të shpenzojnë të paktën gjysmën e këtyre të ardhurave për masat klimatike në BE dhe jashtë saj). Metodologjitë e aplikuar në këtë proces përputhen kryesisht me ato të përdorura nën KKKBNK, specifikisht sipas Udhëzimit të PNKK të vitit 2006⁷. Shqipëria nuk është ende plotësisht në përputhje me Rregulloren 525/2013, e cila lidhet kryesisht me raportimin e GES-it. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit aktualisht harton legjislacionin dytësor për një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e GES-ve, duke përfshirë institucionalizimin e një sistemi kombëtar të inventarit të GES-ve, pasi ky aktualisht bazohet vetëm në projekte. Gjithashtu, si një vend që nuk është pjesë e Aneks I, Shqipëria raporton aktualisht nën parakushte të ndryshme sipas UNFCCC krahasuar me vendet e BE-së, të cilat janë të gjitha vende të Aneksit-I.

Tipari kryesor i ri sipas Rregullores për Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimet për Klimën është se shtetet anëtare të BE-së zhvillojnë Plane Kombëtare

të Energjisë dhe Klimës të integruara, bazuar në një manual të përbashkët. Planet mbulojnë pesë dimensionet e Bashkimit të Energjisë (i) dekarbonizimi (reduktimi i gazit serrë dhe burimet e rinovueshme), ii) siguria e energjisë, iii) efikasiteti i energjisë, iv) hulumtimi i tregut të brendshëm të energjisë, dhe (v) inovacioni dhe konkurrueshmëria, dhe kanë një afat kohor 10-vjeçar. Në vitin 2019, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike, e cila është strategjia e vendit për zhvillimin me karbon të ulët në kontekstin e Marrëveshjes së Parisit. Në dhjetor 2020 u miratua ligji 155/2020 "Për ndryshimet klimatike". Aktualisht është duke u përgatitur një ligj për gazrat e fluorizuar. Ligji për ndryshimet klimatike vendos bazën ligjore për planin kombëtar për energjinë dhe klimën, megjithëse mungojnë dispozita për rolin dhe funksionin e këtij dokumenti, ashtu si për përditësimin e tij. Drafti PKEK është dorëzuar për rekomandime pranë Sekretariatit në korrik 2021⁸. Raportimi sipas rregullores së re bazohet në përvojat e mëparshme dhe bazohet gjithashtu në tabela. Tabela 8 përshkruan një rritje të kompleksitetit në tabelat e përditësuara (p.sh. gaze të ndryshme, lidhje me KTP-në / lejueshmërinë dhe informacion më i zgjeruar mbi mbështetjen).

Për PKEK-në kërkohen raporte dyvjeçare përditësimi të ecurisë së zbatimit. Shtetet anëtare do të raportojnë mbi progresin e bërë në zbatimin e politikave të tyre të energjisë dhe klimës, duke përfshirë planet e tyre kombëtare të energjisë dhe klimës, për herë të parë në mars 2023. MRV-ja e mëparshme dhe e përditësuar është shumë në përputhje me standardet e KKKBNK-së për matje, raportim dhe verifikim që përfitojnë vendet, pasi ato mund të përdorin të njëjtat të dhëna për kërkesa të ndryshme raportimi.

Në përgjithësi, Rregullorja nxit gjithashtu shtetet anëtare që të institucionalizojnë raportimin mbi të dhënat përkatëse për klimën. Për shembull, kërkon që shtetet anëtare të mbajnë një "sistem kombëtar të inventarit" që do të thotë një sistem rregullimesh institucionale, ligjore dhe procedurale të krijuara brenda një shteti anëtar për vlerësimin e emetimeve antropogjene nga burimet dhe largimet nga rezervuarët e gazeve serrë, dhe për rezervuarët e gazeve serrë, dhe për raportimin dhe arkivimin e informacionit të inventarit. Përveç mbledhjes së të dhënave që do të raportohen, Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje për krijimin e strukturave të përhershme raportuese, në mënyrë që të arrijë përputhjen e plotë me kërkesat e BE-së.

5 Agora Energiewende, 2020

6 Energy Community, 2021

7 EU, 2021b

8 Energy Community, 2021

Figura 8: Tabelat e përditësuara të raportimit për energjinë e GES

ANNEX III

Format for reporting on recalculations pursuant to Article 8

Recalculated Year	Per Gas: CO ₂ , N ₂ O, CH ₄							
	GREENHOUSE GAS SOURCE AND SINK CATEGORIES	Previous submission (CO ₂ -eq, kt)	Latest submission (CO ₂ -eq, kt)	Difference (CO ₂ -eq, kt)	Difference (%) ⁽¹⁾	Impact of recalculation on total emissions excluding LULUCF (%) ⁽²⁾	Impact of recalculation on total emissions including LULUCF (%) ⁽³⁾	Explanation for recalculations
Total National Emissions and Removals								
1. Energy								
A. Fuel combustion activities								
1. Energy industries								
2. Manufacturing industries and construction								
3. Transport								
4. Other sectors								
5. Other								
B. Fugitive Emissions from Fuels								
1. Solid fuels								
2. Oil and natural gas								
C. CO ₂ transport and storage								

ANNEX VI

Reporting on approximated greenhouse gas inventories pursuant to Article 7

Member State:	
Reported year 't-1'	
Reporting year 't'	

GREENHOUSE GAS SOURCE AND SINK CATEGORIES	CO ₂ (%)	CH ₄	N ₂ O	HFCs	PFCs	SF ₆	Unspecified mix of HFCs and PFCs	NF ₃	Total	ETS	Effort Sharing (%)
	CO ₂ equivalent (kt)										
Total (net emissions) (%)											
1. Energy											
A. Fuel combustion (sectoral approach)											
1. Energy industries											
2. Manufacturing industries and construction											
3. Transport											
4. Other sectors											
5. Other											
B. Fugitive emissions from fuels											
1. Solid fuels											
2. Oil and natural gas											
C. CO ₂ transport and storage											
2. Industrial processes and product use											
A. Mineral industry											

Burimi: Komisioni Evropian⁹

⁹ Tabela e vjetër gjendet në Rregulloren Zbatuese të BE-së Nr. 794/2014, tabela e re në Rregulloren Zbatuese Nr. 2020/1208.

4. PRAKTIKA TË MIRA RAJONALE – GJEORGJIA

Në këtë kapitull është rishikuar praktika e mirë e ngritjes dhe zbatimit të sistemit MRV të ndryshimit të klimës në Gjeorgji. Ashtu si Shqipëria, Gjeorgjia është një vend kandidat për anëtarësim në BE, dhe mbi këtë bazë, mësimet e nxjerra prej praktikës së tij janë me vlerë për Shqipërinë.

Mungesa e një sistemi vendor MRV me rregulla dhe procedura standarde që gjurmojnë prirjet e përgjithshme të emetimeve të GES-eve, përfitimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbështetjes financiare nxitën zhvillimin e një sistemi kombëtar gjithëpërfshirës MRV në Gjeorgji. Për këtë qëllim, në RDP-në e parë të saj në vitin 2016, Gjeorgjia propozoi ngritjen e një sistemi kombëtar MRV.

Që nga viti 2016, Gjeorgjia zbaton me sukses një sistem kombëtar MRV. Ajo ka përdorur një qasje me faza për zhvillimin e një sistemi MRV të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës dhe efektiv për mbledhjen, menaxhimin dhe analizën efektive të të dhënave në të gjithë sektorët dhe fushat e zbatimit¹⁰.

Sistemi aktual buron nga përpjekjet për të monitoruar zbatimin e projekteve të Mekanizmit për Zhvillim të Pastër në sektorin e energjisë, sipas Protokollit të

Kiotos. Në të njëjtën kohë, ai ishte parashikuar fillimisht për matjen, raportimin dhe verifikimin për projektet VKPZ të mbështetura me fonde ndërkombëtare, gjë që do të thotë se ngritja e tij në nivel kombëtar u bazua në më shumë se një dekadë përvojë në nivel projekti.


4.1. Kuadri ligjor

Një rregullim i procedurave ligjore është thelbësor për funksionimin e sistemit MRV. Gjeorgjia zhvilloi një dokument ligjor bazë (organik) në RDP-në e saj të dytë për të përmbushur detyrimet e ardhshme të raportimit sipas KKKBNK-së dhe traktateve të tjera ndërkombëtare.

Ligji i vitit 2014 për mbrojtjen e mjedisit i ngarkon "operatorët" që të respektojnë standardet e emetimeve dhe t'i monitorojnë ato. Ai më tej mandaton zhvillimin e një kuadri ligjor për ndryshimet klimatike. Ligji i 2016-ës për mbrojtjen e ajrit detyron pajtueshmërinë me standardet e emetimeve të GES-eve dhe ngarkon agjencitë qeveritare që të përmbushin angazhimet e Marrëveshjes së Parisit. Në Janar 2021, Dekreti 54/2020 themelon Këshillin e Ndryshimeve Klimatike.

Në qershor 2021 u miratuan për të udhëhequr zbatimin e KKP-së, Strategjia e Gjeorgjisë për Ndryshimet Klimatike 2030 dhe Plani i Veprimtimit 2021-2023¹¹.

Figura 9: Kuadri i sistemit MRV të Gjeorgjisë



Burimi: Partnership on Transparency in the PA, 2019

¹⁰ GIZ, 2019

¹¹ Informacione të mëtejshme dhe kopje të legjislacionit të referuar (disa në gjuhën gjeorgjiane) janë të disponueshme nga baza e të dhënave për ligjin dhe qeverisjen e klimës në Grantham Research Institute.

4.2. Kuadri institucional

Kuadri institucional për MRV-në në Gjeorgji përcakton qartë role dhe përgjegjësi për aktorë të ndryshëm kyç. Palët e duhura të interesuara u përzgjedhën përmes një procesi konsultativ.

Siç tregon figura 9, funksionimi i sistemit kombëtar MRV mbikëqyret nga Komiteti Koordinues i Strategjisë së Zhvillimit të Emisioneve të Ulëta nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Bujqësisë.

4.3. Operacioni teknik

Ministria formoi një grup teknik me ekspertë teknikë dhe të industrisë i cili hartoi udhëzime dhe procedura të hollësishme dhe të forta që mbulojnë:

1. MRV e emetimeve të GES-eve;
2. Bashkëpërfitimet e OZHQ-ve;
3. Mbështetjen financiare.

Grupi i ekspertëve ka zhvilluar standarde, formate dhe procedura të përbashkëta, ndërsa është përgjegjës për përcaktimin e të dhënave bazë të emetimeve; metodologjitë e përdorura u bazuan në Udhëzimet e PNNK-së të vitit 2006. Grupi i ekspertëve është gjithashtu përgjegjës për zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë dhe zhvillimin e raporteve të monitorimit.

U krijua një sistem i brendshëm i regjistrimit, në të cilin grupi dokumenton veprimet zbutëse, përshkrimin e çdo aktiviteti dhe parametrat që duhen monitoruar. Më pas, përcaktohen përgjegjësitë e matjes dhe mbledhjes së të dhënave së bashku me proceset e raportimit dhe verifikimit. Zyra Kombëtare e Statistikave ofron një sistem të veçantë për raportimin/mbledhjen e veaktive dhe të besueshme të të dhënave në lidhje me aktivitetet zbutëse, gjithashtu dhe raportimin tek subjektet zbatuese dhe grupi i ekspertëve.

Mbi software-in ose modelimin IT të përdorur nuk ka informacion.

4.4. Përfshirja e sektorit privat

Gjeorgjia ka zhvilluar një sistem MRV të fuqishëm, të realizueshëm dhe me kosto efektive përmes një procesi që bashkoi palët kryesore të interesuara nga qeveria, sektori privat dhe shoqëria civile.

Në kuadër të programit, u zhvilluan trajnime dhe seminare për të zhvilluar kapacitetin e të gjitha palëve të interesuara dhe për t'u mundësuar atyre të krijojnë një arkivë të pasur të të dhënave në përputhje me kërkesat e sistemeve të avancuara ndërkombëtare MRV.

U zhvilluan mekanizma të përgjigjes në nivel sektori dhe projekti mbi bazën e të cilëve analizohet impakti i veprimeve dhe jepet informacion për vendimmarrësit.

4.5. Zhvillimi i kapaciteteve

Një numëri i gjerë trajnimesh dhe seminaresh për grupet e interesit mundësuan zhvillimin e kapaciteteve në nivele të ndryshme për matje, verifikim dhe raportim të të dhënave.

4.6. Mësimet e mësuara

Pas rishikimit të përvojës së Gjeorgjisë, mund të nxirren mësimet e mëposhtme:

- Është e rëndësishme pasja e një zyre kombëtare të statistikave përgjegjëse për përpunimin e të dhënave, kryerjen e anketimeve dhe ofrimin e aksesit të barabartë në informacion; në vitin 2017, kjo zyrë e statistikave, së bashku me ministrinë e linjës, zhvilluan tregues dhe objektiva për të gjitha OZHQ-të, të ndërlidhura me reduktimin e emetimeve të GES-eve;
- Mbështetja politike është e rëndësishme, dhe kjo duhet kuptuar e lidhur me Marrëveshjen së Anëtarësimit të një vendi në BE, e cila promovon llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve publike;
- Mbështetja teknike është po aq e rëndësishme, dhe për këtë nevojitet përfshirja e eksperteve teknik të sistemit MRV përgjatë të gjithë procesit të ngritjes dhe zbatimit të saj;
- Në RDP-në e dytë u morën nisma përtë bërë sistemin MRV edhe më efektiv dhe përtë rritur transparencën e veprimeve zbutëse dhe përshtatëse; sistemi MRV në Gjeorgji u ngrit mbi sistemet dhe infrastrukturën ekzistuese;
- Mbështetja në burime financiare ndërkombëtare të veçanta për ngritjen e sistemit MRV është e nevojshme në kushtet e një buxheti kombëtar të kufizuar.

5. STATUS QUO E MRV SË NDRYSHIMIT TË KLIMËS NË SHQIPËRI

Aktualisht, krijimi i një sistemi të matjes, raportimit dhe verifikimit të ndryshimeve klimatike në përputhje me KKKBNK-në dhe kërkesat e acquis mjedisore dhe klimatike të BE-së është një nga objektivat e politikës së Strategjisë Kombëtare Shqiptare të Ndryshimeve Klimatike dhe Planit Kombëtar të Zbutjes 2021-2030, sipas prioritetit të dytë strategjik - krijimi i një sistemi kombëtar monitorimi, raportimi dhe verifikimi të ndryshimeve klimatike në përputhje me kërkesat e BE-së.

Ligji nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike" është miratuar në dhjetor 2020 dhe ka hyrë në fuqi në korrik 2021. Ligji është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 525/2013. Ai përcakton matjen, raportimin dhe verifikimin si "matje ose vlerësim të kryer në Republikën e Shqipërisë, duke raportuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, verifikimin (sigurimin dhe kontrollin e cilësisë) në nivel kombëtar, si dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare të emetimeve apo performancës së matjes së të dhënave, të përcaktuara në:

- a. Raporti Kombëtar i Inventarit të GES-eve,
- b. KK-të, RDP-të, KKP-të,
- c. Raportet e monitorimit të emetimeve të GES-eve nga operatorët privatë,
- d. Analizat e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike në lidhje me ndryshimet klimatike,
- e. Projektionet e emetimeve të GES-eve sipas burimeve dhe largimet nga depot,
- f. Mbështetja financiare dhe investuese për ndryshimet klimatike.

Ligji përcakton një qasje nga poshtë-lart për matjen, raportimin dhe verifikimin e ndryshimeve klimatike; ai përcakton kuadrin institucional për ndryshimet klimatike, si më poshtë:

Ministria e Mjedisit, aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është institucioni më i lartë qeveritar përgjegjës për ndryshimet klimatike; është pika qendrore kombëtare e KKKBNK-së dhe përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të MRV-së, të procesit të përgatitjes së KK-ve dhe RDP-ve, dhe të procesit të përgatitjes, zbatimit dhe raportimit mbi KKP-të;

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për sistemin kombëtar të inventarit të GES-eve; Ministritë e linjës, fusha e veprimtarisë së të cilave ndikon dhe/ose ndikohet nga ndryshimet klimatike, siç përcaktohet në ligj, mbledhin dhe raportojnë të dhëna në Ministrinë e Mjedisit për ndryshimet klimatike;

Operatorët e sektorit privat, me aktivitet në fushat që lidhen me ndryshimet klimatike, të përcaktuara në ligj, monitorojnë dhe raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit emetimet e GES-eve nga aktiviteti i tyre; Instituti i Statistikave është burimi zyrtar kombëtar, rajonal dhe vendor i të dhënave të Qeverisë së Shqipërisë dhe ofron të dhëna socio-ekonomike dhe demografike në lidhje me ndryshimet klimatike, gjithashtu mbështet Qeverinë e Shqipërisë në zhvillimin e metodologjive kombëtare të nevojshme për raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi ndryshimet klimatike;

Instituti i Gjeoshkencave, institucionet kërkimore-shkencore, universitetet, vënë në dispozicion studimet e tyre mbi ndryshimet klimatike, gjithashtu mbështesin Qeverinë e Shqipërisë për zhvillimin e metodologjive kombëtare të nevojshme për raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar për ndryshimet klimatike;

Njësitë e qeverisjes vendore, për juridiksionin e tyre territorial, mbledhin dhe raportojnë në Ministrinë e Mjedisit të dhëna për veprimet për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe masat përshtatëse në nivel vendor;

Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimet Klimatike është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të përgjegjësive për ndryshimet klimatike nëpër institucionet qeveritare, institucionet shtetërore dhe sektorin privat, siç përcaktohet me ligj; është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e progresit drejt objektivave kombëtare për ndryshimet klimatike dhe rishikimin e tyre; është përcaktuar që përpara hyrjes në fuqi të ligjit me Urdhrin e Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014 "Për krijimin dhe funksionimin e grupit ndërmintor të punës për ndryshimet klimatike", të kryesuar nga Ministri i Mjedisit, me anëtarë nga ministrinë e tjera të linjës.

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë për Mjedisin, miraton procedurat kombëtare për matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave kombëtare për ndryshimet klimatike.

Strategjia dhe ligji për ndryshimet klimatike përbëjnë politikën aktuale kombëtare dhe kuadrin ligjor për ndryshimet klimatike në Shqipëri dhe në veçanti për sistemin e matjes, raportimit dhe verifikimit të ndryshimeve klimatike. Ligji përcakton se aktet nënligjore në bazë të tij do të miratohen brenda 4 viteve nga hyrja e tij në fuqi.

Një projekt-vendim i **Këshillit të Ministrave** "Për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të GES-eve dhe informacioneve të tjera në lidhje me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar, përfshi procedurat dhe afatet kohore përkatëse", është përgatitur si draft akti i parë nënligjor, në bazë të ligjit.

Qëllimi i projekt VKM-së është që të:

- sigurojë raportimin e Shqipërisë në KKKBNK-në dhe Protokollin e Kiotos si Palë që nuk është në Aneks 1, dhe në BE,
- sigurojë raportim transparent, të saktë, të qëndrueshëm, të krahasueshëm dhe të plotë,
- vendosë procedurat kombëtare të kërkuara për matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave për raportim.

Në kuadrin institucional për ndryshimet klimatike të përcaktuara me ligj, projekt VKM përcakton kuadrin institucional të sistemit të matjes, raportimit dhe verifikimit të ndryshimeve klimatike me këto specifika:

Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për miratimin dhe përshtatjen e procedurave kombëtare të nevojshme për zbatimin e sistemit MRV, mbikëqyrjen e rrjedhës së të dhënave dhe verifikimin e të dhënave, gjithashtu arkivimin e të dhënave dhe dokumenteve të raportuara.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për zhvillimin e faktorëve kombëtarë të emetimeve të GES-eve dhe metodave kombëtare të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave të ndryshimeve klimatike, përfshi llogaritjen, vlerësimin, pasigurinë, sigurimin e cilësisë dhe metodat e kontrollit, si dhe parashikimet, sipas rastit për Shqipërinë;

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore mbështet Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përgatitjen e sistemit kombëtar të inventarit të GES-eve dhe në zhvillimin e faktorëve të emetimit dhe metodologjive kombëtare të nevojshme për raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi ndryshimet klimatike, përfshi llogaritjen, vlerësimin, pasigurinë, metodat e sigurimit dhe kontrollit të cilësisë, si dhe projeksionet, në lidhje me fushën e veprimtarisë së saj në sektorin e energjisë;

Ministritë e linjës, fusha e veprimtarisë së të cilave ndikon dhe/ose ndikohet nga ndryshimet klimatike, siç përcaktohet në ligj, mbledhin dhe raportojnë të dhëna për veprimet për zbutjen e GES-eve, masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe/ose strategjitë e zhvillimit me karbon të ulët të zhvilluara dhe zbatuara si pjesë të dokumenteve të tyre strategjike sektoriale, mbështesin për verifikimin e të dhënave nëpërmjet zbatimit të planit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë, llogaritjen dhe raportojnë parashikimet e emetimeve të GES-eve sipas burimeve dhe largimeve nga depot.

Ligji dhe projekt VKM-ja nuk plotësojnë ende kuadrin kombëtar për ngritjen e sistemit MRV; ka disa boshllëqe të mëdha të cilat duhen trajtuar:

Së pari, nuk ka metoda kombëtare për matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave: nevojiten metoda dhe formate në çdo nivel të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave të përcaktuara me ligj dhe projekt VKM, nga operatorët e sektorit privat, ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore, INSTAT, Agjencia Kombëtare e Mjedisit; metodat janë kryesisht të nevojshme për (i) identifikimin e faktorëve

kombëtarë antropogjenë të emetimit të GES-eve, përfshi kategoritë e burimit të emetimit dhe kategoritë e nën-kategoritë e depove të largimit, (ii) mbledhjen, vlerësimin, llogaritjen ose matjen e të dhënave, (iii) vlerësimin e pasigurisë, (iv) sigurimin dhe kontrollin e cilësisë dhe (v) projeksionin e emetimeve të GES-eve nga burimet dhe largimet nga depot; formatet janë të nevojshme kryesisht për monitorimin dhe raportimin e të dhënave, si dhe për sistemin e arkivimit.

Së dyti, nuk ka struktura administrative, procedura dhe procese të shkëmbimit të të dhënave: nevojiten struktura dhe procedura të brendshme administrative në secilën prej institucioneve qeveritare dhe shtetërore me përgjegjësi për MRV-në e përcaktuar me ligj dhe projekt VKM, me qëllim funksionimin e përgjegjësive të tyre dhe sigurimin e një rrjedhe të verifikuar në kohë dhe të vazhdueshme të të dhënave; për të njëjtin qëllim, nevojiten procese të shkëmbimit të të dhënave me operatorët e sektorit privat.

Së treti, projekt VKM-ja duhet të rishikohet përpara se të paraqitet për miratim, sipas objektivave të mëposhtme:

- a. për t'u harmonizuar me rregulloret e reja të raportimit të BE-së nën Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimit Klimatik, (ndërkohë që aktualisht është në përputhje vetëm me Mekanizmin e Monitorimit të Klimës);
- b. për të dhënë specifitime mbi përgjegjësitë e operatorëve të sektorit privat, të cilat aktualisht mungojnë;
- c. për të dhënë specifitime për përgjegjësitë e njësisë të qeverisjes vendore, të cilat aktualisht mungojnë,
- d. për të dhënë specifitime mbi përgjegjësitë e GNMPNK, të cilat aktualisht mungojnë;
- e. për të dhënë specifitime mbi përgjegjësitë e ministrive të linjës dhe agjencive të tyre, të cilat aktualisht janë jo të plota;
- f. për të përmirësuar qasjen nga poshtë-lart të sistemit MRV.

Së katërti, duhet të projektohet buxheti kombëtar për zbatimin e sistemit MRV: investimi fillestar dhe kostot vjetore të funksionimit dhe mirëmbajtjes së (i) metodave kombëtare, (ii) strukturave administrative, procedurave dhe proceseve të shkëmbimit të të dhënave, dhe (iii) përgjegjësive të përcaktuara të qeverisë dhe institucioneve shtetërore me projekt VKM-në e rishikuar duhet të projektohen dhe të informojnë një analizë kosto-efektiviteti të zbatimit të sistemit MRV, që do të jetë baza për miratimin e sistemit MRV nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

6. HAPAT PËR PARAPËR ZHVILLIMIN E MRV SË TË DHËNAVE TË NDRYSHIMIT TË KLIMËS NË SHQIPËRI

6.1. Sfidat në ngritjen dhe zbatimin e sistemit MRV

Aktualisht, Qeverisë së Shqipërisë i mungojnë kapacitetet teknike për të plotësuar kuadrin rregullator kombëtar për ngritjen e sistemit të matjes, raportimit dhe verifikimit të ndryshimeve klimatike; po ashtu, i mungojnë kapacitetet teknike për të zbatuar sistemin.

Deri më tani, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përgatitur tre KK, në vitin 2002, 2009 dhe 2016, RDP-në e parë, dy KKP, në 2015 dhe 2021 dhe aktualisht po përgatit Komunikatën e Katërt Kombëtar. Burimet e të dhënave kanë qenë Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (përfshirë Transportin dhe Industrinë), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nisma Transparente e Industrive Nxjerrëse dhe INSTAT. Megjithatë:

- të dhënat e mundësuar nuk kanë qenë sipas Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike,
- faktorët kombëtarë të emetimeve janë përfaqësuar nga faktorët e paracaktuar të Udhëzimeve të Rishikuara të PNNK-së së vitit 1996 për Inventarët Kombëtarë të Gazeve me Efekt Serrë,
- sektorët me pasiguri të lartë në vlerësimin e emetimeve janë deri tani të panjohur,
- mungon një informacion i detajuar mbi gjendjen e bazave të të dhënave ekzistuese nga këto burime.

Gjithashtu, përkushtimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare dhe shtetërore në raportimin e ndryshimeve klimatike deri më tani ka qenë i dobët dhe ka munguar aktiviteti koordinues i GNMPNK-së.

Së fundi, nuk është kryer asnjë monitorim i rregullt i zbatimit të dokumenteve strategjike në lidhje me ndryshimet klimatike, konkretisht të KKP-së 2015, SNKPV-së 2019-2030 dhe dokumenteve strategjike sektoriale, ndër të cilat më të rëndësishmet janë Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2030 dhe Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030¹²; këto dokumente parashikojnë plane monitorimi të zbatimit, megjithatë, ato nuk janë në përputhje ose nuk janë përgatitur për qëllimin dhe objektivin e MRV-së për ndryshimet klimatike, dhe veçanërisht jo në përputhje me kërkesat e raportimit

në lidhje me veprimet për zbutjen e GES-eve, dhe masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe/ose strategjive të zhvillimit me karbon të ulët të hartuara dhe zbatuara në nivel sektorial.

Shkaku i mungesës aktuale të kapaciteteve teknike pas gjithë këtyre viteve të raportimit kombëtar është përfshirja e ulët e qeverisë dhe institucioneve shtetërore në proceset e zhvillimit të tyre; përfshirja e ulët ka qenë rrjedhojë e mungesës së një baze ligjore kombëtare për ndryshimet klimatike gjatë gjithë këtyre viteve, si dhe mungesës së ndarjes së përgjegjësisë dhe roleve të institucioneve, duke pasur parasysh që ligji për ndryshimet klimatike ka hyrë në fuqi jo më parë se prej muajit korrik 2021.

6.2. Elementet për një sistem MRV eficient dhe efektiv

Sipas analizës së paraqitur, mendimet dhe rekomandimet në vijim janë të vlefshme për ngritjen dhe zbatimin e një sistemi eficient dhe efektiv kombëtar të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave të ndryshimit të klimës.

1. Pasqyrimi i plotë i kërkesave ndërkombëtare

Analiza në kapitullin 3 përshkruan detyrimet e raportimit ndërkombëtar për Shqipërinë si Palë në KKKBNK dhe si vend kandidat për anëtarësim në BE, dhe tregon nevojën për të hartuar sistemin e ardhshëm të MRV-së në përputhje me kërkesat e Kuadrit të Transparencës së Marrëveshjes së Parisit (pajtueshmëri deri në fund të 2024) dhe rregulloren e rishikuar të BE-së (pajtueshmëri deri në 2022). Për më tepër, duhet të merren parasysh në të ardhmen udhëzimet e përditësuara të PNNK-së 2019 për inventarët kombëtarë të GES-eve. Këto kërkesa të reja raportimi vijnë si rezultat i aplikimit të programeve të reja software, që janë zhvilluar kohët e fundit¹³. Të dyja, kërkesat e BE-së dhe KKKBNK-së tregojnë në nevojën për të gjurmuar të dhëna më të hollësishme dhe të lidhura me klimën që do të paraqiten në formatet RMM dhe RDT.

2. Mbledhja e të dhënave të hollësishme

Për të qenë i besueshëm KTP bazohet në parimet TACCC (transparenca, saktësia, qendrueshmëria, krahasueshmëria dhe plotësia). Këto parime duhet të pasqyrohen qartë në hartimin dhe zbatimin e çdo sistemi MRV. Për të ilustruar, në vijim paraqitet ushtrimi me i fundit për përmirësimin e KKP-së ekzistuese të Shqipërisë të vitit 2015 nëpërmjet masave të

¹² Instituti i Kërkimeve Urbane, 2021b

¹³ GKE të KKKBNK-së po punon për një software të përmirësuar për RDT-në.

eficiencës së energjisë¹⁴; kështu, figura 10 tregon ndërlidhjet e MRV-së së të dhënave të energjisë me ciklin e përgatitjes së KKP-së; statistikave të energjisë ndihmojnë në identifikimin e përdorimit të energjisë sipas llojit të karburantit dhe (nën)sektorit; për të vlerësuar status quo-në dhe të dhënat bazë, zbatohen metodat e inventarit të GES-eve dhe udhëzimet e PNNK-së; në fund, analiza e kërkesës për energji nga sektorë të ndryshëm përcakton zonat që kanë nevojë për ndërhyrje të mëtejshme për të reduktuar kërkesën për energji dhe emetimet e GES-it; statistikave në vijim janë të nevojshme:

- Konsumi total i energjisë primare (TPEC) sipas burimit (oferta dhe kërkesa): hidrocentralet, hidrokarburet (nafta, qymyri), karburantet bio dhe mbetjet
- Konsumi total i energjisë finale (TFEC) sipas llojit: elektrike, ngrohje, ftohje, etj. dhe sipas sektorëve: banim/familje, transport, industri, tregti, shërbime publike, bujqësi, pylltari etj.
- Intensiteti i energjisë dhe statusi i efikasitetit të energjisë: banim/familje, transport, industri, tregti, shërbime publike, bujqësi, pylltari etj..
- konsumi i energjisë për PBB,
- konsumi i energjisë në prodhim (ton ekuivalent naftë, miliarda),
- intensiteti i energjisë së prodhimit (ton ekuivalent naftë për vlerën e shtuar të prodhimit 1000 dollarë, konstante 2010 \$).

Për interpretimin e treguesve të energjisë dhe llogaritjen e potencialit për rritjen e efikasitetit


të energjisë janë të nevojshme të dhëna dhe informacione shtesë mbi kërkesën dhe konsumin e energjisë nga nënsektorët:

- Ndërtimi: kërkesa/konsumi specifik i energjisë për sipërfaqe kati (kWh/m²a), i ndarë në mënyrë ideale nga lloji i ndërtesës, vjetërsia dhe furnizimi aktual me energji;
- Rezidenciale: mënyrat e gatimit dhe furnizimi me ujë të ngrohtë; shkalla e depërtimit të pajisjeve elektrike etj.;
- Transporti: konsumi mesatar i energjisë specifike të automjetit për 100 km.

Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të status-quo-së dhe bazës, të dalluar sipas llojit të burimit të energjisë. Nga kjo hartë e energjisë mund të bëhen parashikime afatmesme dhe afatgjata për të gjithë sektorët përkatës për të përcaktuar veprime shtesë zbutëse gjatë raundit të ardhshëm të rishikimit të KKP.

Për një MRV të përshtatshme të progresit të KKP-së, si dhe për raportet e ardhshme dyvjeçare të inventarit të GES-eve në kuadër të RDP-ve, kërkohet një mbulim më i mirë me të dhëna. Sistemet ekzistuese MRV kanë nevojë për përditësim në disa nivele. Për këtë, rishikimi i projekt VKM-së për MRV-në e të dhënave të ndryshimeve klimatike për të përfshirë kërkesat e reja të raportimit të BE-së nën Qeverisjen e Bashkimit të Energjisë dhe Veprimit për Klimën, si dhe kërkesat e MP RDT-së, është një hap i parë i dobishëm.

Figura 10: Të dhënat për energjinë në KKP



3. Rregullim dhe procedura institucionale të qëndrueshme

Rolet dhe përgjegjësitë e qeverisë dhe institucioneve shtetërore të përfshira në sistemin MRV kanë nevojë të përcaktohen më qartë në projekt VKM-në përkatëse, dhe njëkohësisht, të përshtaten me qasjen nga poshtë-lart të sistemit, përkundrejt qasjes nga lart-poshtë që aktualisht paraqet projekt VKM-ja. Veçanërisht, roli i Ministrisë për Energjinë, agjencive të saj dhe INSTAT ka nevojë për përkufizime të mëtijshme në lidhje me procesin e mbledhjes së të dhënave të hollësishme.

Për më tepër, shembulli i Gjeorgjisë dha dëshmi të suksesit të krijimit të një Grupi Teknik që përfshin jo vetëm ekspertë nga institucionet qeveritare, por edhe ekspertë teknikë dhe të industrisë nga sektori privat dhe akademia. Një grup i tillë mund të përmirësojë procesin e mbledhjes së të dhënave përmes standardeve, formateve dhe procedurave të përbashkëta.

Mund të kërkohet një rregullim i mundshëm i kuadrit (nën) ligjor dhe rregulloreve përkatëse për zbatimin e këtyre procedurave dhe standardeve të reja. Së fundi, do të kërkohen kapacitete të ndryshme për krijimin e një kuadri të fortë MRV. Siç ilustron nga ËRI (216), nevojiten kapacitete të ndryshme njerëzore, institucionale, teknike dhe financiare. Në shembullin e Gjeorgjisë, trajnime dhe seminare të gjera për institucione të ndryshme të përfshira dhe palët e interesuara kontribuan në zhvillimin e kapaciteteve në nivele të ndryshme duke aftësuar stafin përgjegjës të maste dhe raportonte me sukses të dhënat përkatëse.

4. Kapacitete të zhvilluara

Së fundi, për ngritjen e sistemit MRV nevojiten kapacitete të ndryshme. World Resources Institute ka identifikuar dhe kategorizuar kapacitetet e nevojshme njerëzore, institucionale, teknike dhe financiare.

5. Procedurat e sigurimit të cilësisë

Verifikimi të dhënave është një element kyç për të bërë të besueshme sistemet MRV dhe rezultatet e raportuara të tyre. Ndërsa ka disa rishikime të parashikuara të cilësisë në nivel ndërkombëtar, si rishikimet e ekspertëve dhe vlerësimi mbështetës shumëpalësh i ecurisë sipas Marrëveshjes së Parisit, në nivel kombëtar verifikimi mbetet i kufizuar. Rishikimi dhe miratimi i projekt VKM-së do të mundësojë ngritjen e proceseve të verifikimit.

6. Akses i mbështetjes ndërkombëtare

Duke pasur parasysh kapacitetet e nevojshme për zbatimin e sistemeve MRV, zhvillimi i tyre do të jetë një sfidë për vendet në zhvillim. Për të adresuar këtë sfidë, disa organe, institucione dhe iniciativa nën dhe përtej KKKBNK-së mbështesin ngritjen e sistemeve MRV në vendet që nuk janë pjesë e Aneksit I. Si e tillë, Shqipëria ka të drejtë të marrë këtë mbështetje. Kanale të mundshme mbështetëse shumëpalëshe paraqiten në tabelën në vijim. Për më tepër, kanalet dypalëshe si Iniciativa Ndërkombëtare për Klimën nga Gjermania ofrojnë mbështetje për elementët MRV të lidhura me energjinë, siç është përpunimi i PKEK-ve.

Së fundi, Shqipëria është gjithashtu e pranueshme për të marrë mbështetje për ndërtimin e qasjeve MRV

Figura 11: Rregullim i mundshëm institucional për një sistem MRV për të dhënat e energjisë




Figura 12: Kapacitetet e nevojshme për zbatimin e një sistemi të fuqishëm MRV

Kapaciteti	Përshkrimi dhe elementet kryesore
Burimet Njerëzore	<p>Burimet njerëzore janë të nevojshme për të kryer një sërë detyrash dhe funksionesh që lidhen me lloje të ndryshme të MRV. Funksionet tipike përfshijnë: planifikimin e përgjithshëm; koordinimin; menaxhimin dhe mbikëqyrjen teknike; kryerjen e hulumtimeve; mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave; logaritjen e emetimeve; dhe sigurimin e cilësisë/koordinimi i kontrollit të cilësisë.</p> <p>Elementet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kapaciteti dhe aftësitë e personelit individual, përfshi aftësitë menaxheriale dhe aftësitë teknike - Rekrutimi dhe mbajtja e stafit të kualifikuar - Trajnimi i rregullt i stafit të ri dhe ekzistues
Kapaciteti institucional	<p>Kryerja e MRV kërkon institucione që kanë mandatin e nevojshëm dhe procese të qarta dhe efikase</p> <p>Elementet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aftësia e institucioneve për të kryer funksionet e tyre - Rregullime efektive institucionale, procese dhe mekanizma koordinues, lidhës dhe mandate institucionale - Aftësia për të identifikuar problemet dhe për të zhvilluar dhe zbatuar zgjidhje.
Kapaciteti teknik	<p>Nevojat për kapacitete teknike mund të kuptohen në kontekstin e disponueshmërisë së metodologjive të përshtatshme për të marrë të dhëna të sakta dhe platforma adekuate për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave.</p> <p>Elementet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave dhe informacionit - Ruajtja e memories institucionale, procedurat e arkivimit dhe dokumentimit - Mbledhja dhe shpërndarja e informacionit - Infrastruktura teknike dhe teknologjike (p.sh., platformat e mbledhjes së të dhënave dhe teknologjia e monitorimit)
Burimet financiare	<p>Kapaciteti financiar përfshin sigurimin se burimet e mjaftueshme në dispozicion për të filluar dhe mbështetur zbatimin e MRV. Burimet financiare nevojiten për të pajisur qeveritë dhe entitetet e tjera përkatëse për disa detyra të lidhura me MRV-në, të tilla si punësimi i profesionistëve të kualifikuar të dedikuar ekskluzivisht për kryerjen e MRV-së, ndërtimi i kapaciteteve midis palëve të interesuara për të mbështetur zbatimin e MRV-së, vendosja e marrëveshjeve dhe proceseve efektive institucionale dhe zbatimi i sistemeve dhe metodave të reja për mbledhjen e të dhënave</p> <p>Elementet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e funksioneve dhe arritjen e objektivave - Aftësia për të menaxhuar këto burime

Burimi: WRI, 2016

konsistente me BE-në nën Instrumentin për Asistencën e Para-aderimit (IPA II), duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të lidhura me MRV dhe shkëmbimin rajonal.

7. Grup teknik i ekspertëve

Është me vlerë të konsiderohet ngritja e një grupi teknik të sistemit MRV me një numër të gjerë ekspertësh nga institucionet qeveritare, nga sektori privat, përfshirë industrinë, dhe nga akademia; për këtë do të nevojitej rregullimi ligjor përkatës në projekt VKM-në. Ky grup do të bëhej pjesë e të gjitha proceseve të ngritjes dhe zbatimit të sistemit, duke përfshirë metodat kombëtare dhe mbledhjen e të dhënave të hollësishme, rregullimin dhe procedurat institucionale, ngritjen e kapaciteteve, dhe jo vetëm; në këtë rast, mund të jetë e nevojshme të përcaktohet ndërlidhja e këtij grupi me GNMPNK-në.

8. Konsultim ndërmjet grupeve të interesit

Së fundmi, është me vlerë të konsiderohet ngritja e një platforme për shkëmbim informacioni, diskutim dhe konsultim ndërmjet grupeve të interesit të sistemit MRV.

Figura 13: Organet dhe nismat që mbështesin ngritjen e kapaciteteve për sistemet MRV

Entiteti	Hyrje përmbledhëse	Rëndësia për kuadrin e transparencës së përmirësuar të Marrëveshjes së Parisit
Komiteti i Parisit për ngritjen e kapaciteteve (PCCB)	PCCB u krijua në 2005, gjatë COP21, për të përmirësuar marrëveshjet institucionale të UNFCCC dhe për të mbikqyrur një program gjithëpërfshirës pune që përfshin identifikimin e mangësive dhe nevojave të kapaciteteve; nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal, kombëtar dhe nënkombëtar; vlerësimi i mënyrës se si të rriten sinergjitë, koordinimi, bashkëpunimi dhe koherenca midis organeve dhe aktiviteteve ekzistuese brenda dhe jashtë UNFCCC, duke promovuar zhvillimin dhe shpërndarjen e mjeteve dhe metodologjive përkatëse, dhe mbledhjen e praktikave dhe mësimave më të mira të nxjerra për të rritur pronësinë dhe ruajtjen e kapaciteteve në nivel kombëtar, nivel rajonal dhe nënkombëtar (UNFCCC 2015, para.73).	PCCB-së ka si detyrë përpjekje mbështetëse për zbatimin e Marrëveshjes së Parisit. Boshllëqet dhe nevojat e ndërtimit të kapaciteteve në lidhje me kuadrin e përmirësuar të transparencës janë brenda kësaj përgjegjësie.
Forumi i Durbanit	Në vitin 2011, Palët vendosën të krijojnë Forumin Durban, një diskutim vjetor i thelluar mbi ndërtimin e kapaciteteve (UNFCCC 2011b, para.144). Forumi Durban takohet çdo vit që nga viti 2012 gjatë sesioneve Maj/Qershor të Trupit Ndihmës për Zbatim.	Diskutimet nën Forumin e Durbanit, të cilat janë thelbësore për eksplorimin e përvojave të ndërtimit të kapaciteteve, shpesh përfshijnë diskutime të temave të lidhura me transparencën.
Grupi Konsultativ i Ekspertëve (CGE)	CGE u krijua në 1999 për t'iu përgjigjur veçanërisht nevojës për të përmirësuar përgatitjen e komunikimeve kombëtare (CGE 2008). COP, përmes Vendimit 19/CP.19, vazhdoi CGE për pesë vjet, nga 2014 deri në 2018, dhe mandatoi që, gjithashtu, CGE të ofrojë mbështetje për përgatitjen e BUR-ve (CGE 2018). Në COP24, CGE u zgjat deri në vitin 2026 dhe u mandatua për t'i shërbyer Marrëveshjes së Parisit.	CGE tani është krijuar për t'i shërbyer zbatimit të Marrëveshjes së Parisit, duke përfshirë mbështetjen për përgatitjen e raporteve dyvjeçare të transparencës.
Iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve për transparencë (CBIT)	Në Vendimin 1/CP.21, paragrafi 84, vendet krijuan CBIT për të mbështetur vendet në zhvillim në përbushjen e kërkesave të tyre sipas nenit 13. Vendimi gjithashtu përvijoi tre objektiva kryesore të CBIT: "(a) të forcojë institucionet kombëtare për aktivitetet e lidhura me transparencën në përputhje me prioritetet kombëtare; (b) të ofrojë mjete përkatëse, trajnime dhe ndihmë për përbushjen e dispozitave të përcaktuara në nenin 13 të Marrëveshjes; (c) të ndihmojë në përmirësimin e transparencës me kalimin e kohës" (UNFCCC 2015a, para 85)	CBIT pritet të luajë një rol kyç për të ndihmuar vendet që të përbushin kërkesat e transparencës siç përcaktohet në nenin 13 të Marrëveshjes së Parisit, siç mandatohet nga Vendimi 1/CP.21, paragrafi 84.
Fondi Global i Mjedisit (GEF)	Përveç pritjes së nismës për ndërtimin e kapaciteteve për transparencë (shih hyrjen më lart), GEF ka mbështetur prej kohësh marrëveshjet e transparencës sipas Konventës duke dhënë mbështetje për përgatitjen e NC-ve dhe BUR-ve.	Këto raporte kombëtare ofrojnë bazën për marrëveshjet e transparencës sipas Marrëveshjes së Parisit.
Fondi i Gjelbër i Klimës (GCF)	Programi i Gatishmërisë dhe Mbështetjes Përgatitore të GCF ofron mbështetje për zhvillimin e Planeve Kombëtare të Përshtatjes (NAP) dhe proceseve të tjera të planifikimit të përshtatjes (GCF n.d). Përpjekjet gjithashtu në kuadër të Programit të Gatishmërisë dhe Mbështetjes Përgatitore synojnë të përmirësojnë aksesin në financimin e klimës duke përafuar strategjitë kombëtare me propozimet e financimit dhe prioritetet e vendeve (GCF nd).	GCF pritet të luajë një rol kritik në zbatimin e veprimeve zbutëse në lidhje me NDC-të që kërkojnë mbështetje. Përveç kësaj, mbështetja e GCF-së për formulimin e NAP-ve do të forcojë raportimin kombëtar mbi veprimet e përshtatjes. GCF gjithashtu mbështet zbatimin e veprimeve zbutëse.

Nisma	Përshkrimi	Web link
Partneriteti për Transparencën në Marrëveshjen e Parisit (PATPA)	PATPA u krijua në 2016 për të promovuar mbështetjen për shkëmbimin praktik dhe dialogun politik midis vendeve për transparencën e përmirësuar/zgjeruar të klimës (PATPA n.d.). Kjo nismë u ndërtua në partneritetin ndërkombëtar të mëparshëm të vitit 2010 për zbutjen dhe MRV midis Gjermanisë, Afrikës së Jugut dhe Koresë së Jugut. PATPA zgjeroi fushën e saj për të mbuluar transparencën jo vetëm të veprimeve zbutëse, por edhe të përshtatjes dhe mbështetjes. Më shumë se 100 vende marrin pjesë në aktivitetet e PATPA, së bashku me agjenci të shumta, organizata kërkimore dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare (PATPA n.d.)	www.transparency-partnership.net/
Çështjet e Informacionit	Information Matters/ Çështjet e Informacionit është një projekt i GIZ, agjencisë gjermane të zhvillimit ndërkombëtar. Projekti synon të mbështesë vendet në përgatitjen e raporteve të tyre të transparencës sipas Konventës. Ai e bën këtë përmes qasjeve specifike për vendet në zhvillim në konsultim të ngushtë me palët e interesuara të vendit dhe përmes seminareve kombëtare, të cilat bashkojnë ekspertë të vendit dhe ndërkombëtarë (GIZ n.d.).	www.giz.de/world-wide/30164.html
Iniciativa për Transparencë të Veprimit Klimatik (ICAT)	ICAT u krijua në 2006 për të promovuar përdorimin e një kuadri të përbashkët vullnetar për të vlerësuar ndikimet e politikave dhe veprimeve të vendeve, për të raportuar progresin dhe për të nxitur transparencë, efektivitet dhe ambicie më të madhe (ICAT 2016). Nisma mbështet në zhvillimin e aktiviteteve udhëzuese dhe të ngritjes së kapaciteteve për të përmirësuar disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave dhe për t'u mundësuar vendeve të promovojnë politika efektive dhe me kosto efektive. Përveç zhvillimit të udhëzimeve, ICAT integron aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive për të angazhuar vendet në përdorimin e një kuadri të përbashkët.	www.climateactiontransparency.org/
Partneriteti për të Forcuar Transparencën për Bashkë-Inovacion (PaSTI)	PaSTI kërkon të mbështesë vendet në zhvillim, veçanërisht në rajonin Azi-Paqësor, për të forcuar transparencën duke angazhuar aktorë joshjetërorë dhe duke zhvilluar mekanizma inovativë nxitës që mbështesin shkëmbimin e të dhënave (Qendra e Bashkëpunimit Mjedisor Jashtë Shtetit, Japoni 2019).	www.oecc.or.jp/e/pasti/index.html
Koalicioni për Ngritjen e Kapaciteteve të Marrëveshjes së Parisit	Koalicioni përbëhet nga një grup ekspertësh me përvojë në gazrat serrë, MRV dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve. Ky koalicion ka ofruar një forum ekspertësh për koordinimin dhe përshtetjen e aktiviteteve të përmirësuar të ndërtimit të kapaciteteve dhe ka publikuar rekomandime për strategjinë e ndërtimit të kapaciteteve, duke përfshirë kontributin e ekspertëve për PCCB dhe CBIT. (Koalicioni për Ngritjen e Kapaciteteve të Marrëveshjes së Parisit 2019).	www.capacitybuildingcoalition.org/
Partneriteti për gatishmërinë e tregut (PMR)	PMR mbledh vendet, organizatat dhe ekspertët për të eksploruar dhe identifikuar qasje inovative për zbutjen e GS duke përdorur tregjet dhe çmimet e karbonit, duke përfshirë sistemin themelor MRV. Një rrjedhë pune MRV fokusohet në zhvillimin e udhëzimeve për zbatimin dhe dizajnimin e sistemeve MRV që mund të mbështesin përpjekjet për çmimin e karbonit (PMR 2016).	www.thepmr.org/
Partneriteti Global i Strategjive të Zhvillimit të Emisive të Ulëta (LEDS-GP)	LEDS-GP synon të avancojë zhvillimin e emetimeve të ulëta rezistente ndaj klimës dhe të mbështesë tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët përmes koordinimit, informacionit, shkëmbimit dhe bashkëpunimit midis vendeve dhe organizatave kryesore.	www.ledsgp.org
Bashkëpunimi kërkimor i udhëhequr nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për të gjurmuar financat private klimatike.	Bashkëpunimi kërkimor i OECD-së i sjell qeveritë, institucionet kërkimore dhe institucionet financiare ndërkombëtare që të partnerizohen dhe të ndajnë të dhënat, ekspertizën dhe informacionin më të mirë të disponueshëm për të çuar përpara kërkimin përkatës për politikën për ndjekjen e financave private të klimës në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në kohë. Ky bashkëpunim synon të kontribuojë në hartimin e udhëzimeve ndërkombëtare për gjurmimin dhe transparencën e mbështetjes (OECD 2018).	www.oecd.org/finance/tracking-climate-finance.html

Burimi: WRI (2019), p.26 dhe p.42

7. PËRFUNDIME

Duke qenë palë në KKKBNK-në dhe vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria është zotuar të përmbushë disa kërkesa matje, raportimi dhe verifikimi mbi ndryshimin e klimës në nivel kombëtar. Këto kërkesa janë të ndërlidhura, për këtë arsye një sistem i ardhshëm kombëtar MRV duhet të krijohet mbi bazë sinergjie. Ndërsa sistemi aktual për raportimin e KKKBNK-së është i vlefshëm deri në fund të vitit 2024, nevojitet të fillohet hartimi dhe zbatimi i një Kuadri të Transparencës së Përmirësuar që përmbush kërkesat e Marrëveshjes së Parisit, e për rrjedhojë, të merren parasysh udhëzimet e rishikuara të PNNK-së të vitit 2019 për inventarët kombëtarë të gazeve me efekt serrë, si dhe përdorimi i programeve të reja software.

Ushtrimet e mbledhjes së të dhënave të energjisë në kuadër të përmirësimit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar për reduktimin e emetimit të gazeve me efekt serrë 2021-2030, ashtu si dhe praktika të mira ndërkombëtare, tregojnë se sistemi i ardhshëm kombëtar MRV duhet të gjurmohet të dhëna më të hollësishme, veçanërisht në lidhje me nxitësit e kërkesës për energji. Institucionet shtetërore dhe qeveritare të tanishme nuk ofrojnë të dhëna të tilla; strukturave të brendshme administrative e procedurave nevojiten për këto institucione, dhe metoda dhe formate kombëtare në çdo nivel të mbledhjes së të dhënave.

Për shkak të fondit buxhetor kombëtar të kufizuar, nevojitet një parashikim i buxhetit për zbatimin e sistemit MRV, i cili t'i propozohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për diskutim, dhe të përfshijë investimin fillestar dhe kostot operative dhe të mirëmbajtjes së (i) metodave kombëtare, (ii) strukturave administrative, procedurave dhe proceseve të shkëmbimit të të dhënave, dhe (iii) zbatimit prej institucioneve shtetërore e qeveritare

të rolit dhe përgjegjësive të tyre ligjore; përfshirja e sektorit privat në sistem mund të kërkojë gjithashtu fond financiar të veçantë.

Projekt VKM-ja "Për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të GES-eve dhe informacioneve të tjera në lidhje me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar, duke përfshirë procedurat dhe planin kohor përkatës" duhet të miratohet deri në korrik 2025, siç kërkohet nga ligji 155/2020 "Për ndryshimet klimatike"; prandaj, rishikimi i saj duhet të jetë prioritet në dy vitet e ardhshme. Gjatë rishikimit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rregullimit të një qasjeje nga poshtë-lart të sistemit MRV; veçanërisht, nevojitet një shqyrtim i kujdesshëm i bazës ligjore të krijimit dhe funksionimit të institucioneve qeveritare me përgjegjësi në zbatimin e sistemit, me qëllim që të sigurohet që rregullimi i përgjithshëm institucional nga poshtë-lart i vendosur nga ligji, të pasqyrohet edhe në rregullimet specifike të VKM-së.

Bashkëpunimi në plan afatgjatë me të gjithë aktorët e sistemit MRV është i nevojshëm për gjatë të gjithë procesit të ngritjes dhe zbatimit të tij; sipas shembullit të suksesshëm të Gjeorgjisë, një grup teknik me ekspertë të të gjithë sektorëve dhe fushave të ndërlidhura me matjen, raportimin dhe verifikimin e të dhënave të ndryshimit të klimës mund të jetë një formë e organizimit të këtij bashkëpunimi.

Për të mbështetur procesin kompleks të ndërtimit të një sistemi MRV, Shqipëria mund të përdorë organe dhe nisma të ndryshme ndërkombëtare nën dhe përtej KKKBNK-së. Në këtë drejtim, financimi i GCF dhe GEF dhe mbështetja e BE-së për IPA II janë të mundshme e të dobishme.

Referenca

Agora Energiewende, 2020. Policy Note [Vlerësim i politikës]. [Online]. Gjendet në: https://static.agora-energiewende.de/fileadmin/Partnerpublikationen/2021/Klimapolitika_NECPs_as_governance_tools/NECP_Paper_1_Klimapolitika_FINAL.pdf

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. 2018. National Benefits of Climate Reporting [Përfitimet kombëtare nga raportimi për klimën]. Dokument për diskutim. Partnership on Transparency in the Paris Agreement. [Online]. Gjendet në: https://transparency-partnership.net/system/files/document/GIZ_2018_National%20benefits%20of%20climate%20reporting.pdf

Energy Community. 2021. Implementation: Albania, Climate [Zbatimi: Shqipëria, Klima]. [Bazë të dhënash]. <https://energy-community.org/implementation/Albania/CLIM.html>

European Union. 2021a. Stabilisation and Association Agreement [Marrëveshja e Stabilizim Asociimit]. [Online]. Gjendet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/glossary/stabilisation-and-association-agreement_de

European Union. 2021b. Emissions monitoring & reporting, Monitoring Mechanism Regulation 525/2013 [Monitorimi dhe raportimi i emetimeve, Rregullorja e Mekanizmit të Monitorimit 525/2013]. [Online]. Gjendet në: <https://www.eea.europa.eu/policy-documents/monitoring-mechanism-regulation-525-2013>.

Grantham Research Institute. 2021. Climate Change Laws of the World [Ligjet për ndryshimin e klimës në botë]. [Online]. Gjendet në: <https://climate-laws.org/>

Minister of Environment and Natural Resources Protection of Georgia. 2016. First Biennial Update Report [Raporti i Parë Dyvjeçar Përditësues]. [Online]. Gjendet në: https://unfccc.int/files/national_reports/non-annex_i_parties/biennial_update_reports/application/pdf/first_bur_-_georgia.pdf

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. 2021. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2020-2030. Dokument në punim.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2021a. KKP e Rishikuar e Shqipërisë. Dokument në punim.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2021b. First Biennial Update Report of Albania to the UNFCCC [Raporti i Parë Dyvjeçar Përditësues i Shqipërisë për KKKBNK]. Dokument në punim.

Öko-Institut. e.V.. 2021. Understanding the Transparency Guidance [Të kuptojmë Udhëzimin për Transparencë]. Dokument në punim. [Online]. Gjendet në: <https://www.oeko.de/en/publications/p-details/understanding-the-transparency-guidance>

Partnership on Transparency in the Paris Agreement. 2019. National

Referenca

Benefits of Climate Reporting: The MRV System of Georgia [Përfitimet kombëtare nga raportimi për klimën: Sistemi MRV i Gjeorgjisë]. Baza e të dhënave për praktika të mira. [Online]. Gjetet në: https://transparency-partnership.net/system/files/document/200113_GPD_Georgia-Climate-reporting_RZ.pdf

United Nations Framework Convention on Climate Change. 2020a. Consultative Group of Experts – Handbook on institutional arrangements to support MRV/transparency of climate action and support [Grupi Konsultativ i Ekspertëve – Manual mbi rregullimin institucional për MRV-në/transparencën e veprimit për klimën dhe mbështetjes]. [Online]. Gjetet në: https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Hand%20book_EN.pdf

United Nations Framework Convention on Climate Change. 2020b. Technical handbook for developing country Parties on Preparing for implementation of the enhanced transparency framework under the Paris Agreement [Manual teknik për vendet Palë në zhvillim për t'u përgatitur për zbatimin e kuadrit të transparencës së përmirësuar të Marrëveshjes së Parisit]. [Online]. Gjetet në: https://unfccc.int/sites/default/files/resource/ETF_technical%20handbook_First%20Edition.pdf

Instituti i Kërkimeve Urbane. 2021a. Potencial shtesë i eficiencës së energjisë për përmirësimin e KKP-së së Shqipërisë 2030. Green Climate Fund. Projekt për Mbështetje Parapërgatitore. Dokument në punim.

Instituti i Kërkimeve Urbane. 2021b. Gjendja e zbatimit të KKP 2015: Politikat dhe masat e eficiencës së energjisë. Green Climate Fund. Projekt për Mbështetje Parapërgatitore. Dokument në punim.

World Resource Institute. 2016. MRV 101. Understanding Measurement, Reporting, and Verification of Climate Change mitigation. [MRV 101: Të kuptojmë matjen, raportimin dhe verifikimin e zbutjes së ndryshimit të klimës]. [Online]. Gjetet në: <https://www.wri.org/research/mrv-101-understanding-measurement-reporting-and-verification-climate-change-mitigation>

World Resource Institute. 2019. Building capacity for the Paris Agreement's enhanced transparency framework: what can we learn from countries' experiences and UNFCCC processes? [Ngritja e kapaciteteve për kuadrin e transparencës së përmirësuar të Marrëveshjes së Parisit: çfarë mund të mësojmë nga përvoja e vendeve dhe nga proceset e KKKBNK-së?]. [Online]. Gjetet në: <https://www.wri.org/research/building-capacity-paris-agreements-enhanced-transparency-framework>



